

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT

SHPALLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Shofer, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori Shërbimeve Mbështetëse, (Kategoria e pagës klasa VIII).

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); VKB Nr.169, datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.2236, datë 08.08.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë ose dëftesë e arsimit 9-vjeçar (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësisht nga MAS*);
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i një gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Shoferi është në varësi të Përgjegjësit të Sektorit Shërbimeve Mbështetëse dhe kryen këto detyra:

1. Zbaton programin e punës sipas miratimit nga Përgjegjësi i Sektorit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
2. Mirëmban automjetin që ka në përdorim dhe njofton Përgjegjësin e Sektorit kur vë re nevojën për mirëmbajtje apo riparime të nevojshme.
3. Informon Përgjegjësin e Sektorit për çdo problem apo difekt të karakterit teknik, për afatet e kryerjes së kontrollit teknik periodik të detyrueshëm, si dhe për likuidimin e detyrimeve vjetore fiskale dhe siguracionit.
4. Kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga eprorët.
5. Kryen shërbimin e transportit për administratën e institucionit.
6. Qëndron gjatë gjithë kohës në gjëndje gadishmërie.
7. Përgjigjet personalisht për çdo dëmtim që i shkaktohet mjetit si pasojë e gabimeve të tij në drejtimin e tij, si dhe për çdo masë me gjobë të marrë gjatë drejtimit të mjetit.

Dokumentat që aplikanti për Shofer në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori Shërbimeve Mbështetëse, duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë ose dëftesë e arsimit 9-vjeçar (*për diplomat jashtë vendit të përcillet njehsimi nga MAS*) ;
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Vërtetim i aftë për punë;
7. Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë zyrave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, në adresën : Rr: “Asim Vokshi”, Nd.10, H.4, Ap.3, 1057, Tiranë, afati është deri me datë 11.04.2025 **ora** 14.00.